



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
BASHKIA KURBIN

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
më. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2020

Laç,

## RELACION TEKNIK

Në zbatim të Urdherit Nr.32, datë 18.02.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit të plotë teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta të Njesisë Administrative Laç, Njesisë Administrative Milot dhe Njesisë Administrative Fushë-Kuqe”, grupi i punës pas verifikimeve dhe matjeve të nevojshme paraqet materialin si më poshtë vijon:

Bashkia Kurbin ka një popullsi mbi 70.000 banorë dhe ndodhet në një lartësi 20 m mbi nivelin e detit, me klimë mesdhetare, me temperatura mesatare më të ulëta -5 gradë C në dimër (Janar) dhe me një mesatare shumëvjeçare më të lartë +38 gradë C në verë (Korrik).

Për arsye dhe nevojat e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të gjelbërimit në qytetin e Laçit, Njesisë administrative Milot dhe Fushë Kuqe, duke qenë se ky aktivitet ka kaluar tashmë në sipërmarrjet private, Bashkia Kurbin po harton dhe do të kryejë prokurimin e fondeve përkatëse për periudhën 2020-2025.

Për realizimin e detyrës së këtij projekti të mirëmbajtjes dhe shtimit të sipërfaqeve të gjelbërta nëpërmjet shërbimit të gjelbërimit, Bashkia Kurbin ka përcaktuar një fond, nëpërmjet të cilit do të kryhen volume punimesh të caktuara dhe do të bëjë të mundur realizimin e detyrës së caktuar.

Meqënëse ka përfunduar afati i kontratës së parë të sipërmarrësit është kryer inventarizimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe janë përcaktuar volumet e punës për çdo zë punimi që do të mundësojë zhvillimin, ruajtjen, shtimin dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit.

Për kryerjen e shërbimit në tërësi dhe sa më cilësor janë përlllogaritur të gjitha analizat e çmimeve për çdo zë punimi (duke ju referuar praktikës paraardhese).

Aktiviteti i mirëmbajtjes dhe zhvillimit të gjelbërimit (Njësia administrative Laç, Milot, Fushë kuqe) përmban si kërkesë kryesore imediate shërbimet e gjelbërimit, shërbimet agroteknike në sipërfaqet me lule, në sipërfaqet me bar, në sipërfaqet me dru, në drurët dekorativë, në bordurat e gjelbërimit, rrugë dhe sheshe, furnizim dhe vendosje stolash, mbjelljen e pemëve dekorative etj.

Sipërmarrësi do të kontrollojë të gjitha mbjelljet në të gjitha strukturat siç janë: drurët, shkurret, sipërfaqet me bar natyral dhe të kultivuar, sipërfaqet me lule, bordurat e gjelbërta, cilësinë e fidaneve që do të mbillen. Do të marrë në dorëzim të gjithë inventarin e deritanishëm dhe do të përgjigjet për ruajtjen dhe shërbimin e të gjithë infrastrukturës së gjelbërimit të qytetit, duke vënë në dispozicion të gjithë mekanizmat e shërbimit të planifikuar.

Një kujdes i madh në fushën e gjelbërimit të njesisë administrative Laç, Milot dhe Fushë Kuqe

duhet t'i kushtohet sipërfaqeve me lule dhe drurëve dekorativë duke siguruar ruajtjen dhe shtimin e tyre me zëvendësimet eventuale siç janë planifikuar.

Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet nga sipërmarrësi gjatë periudhës së verës në kulmin e temperaturave të mëdha duke siguruar ujin për vaditje të sipërfaqeve të gjelbërimit.

Sipërmarrësi (subjekti fitues) do të garantojë vaditjen e drurëve rrugore të rinj deri në tre vjet pas sezonit të mbjelljes si dhe sipërfaqet me lule që nuk kapen nga rrjetet e ndryshme të furnizimit me ujë me anë të autobotëve.

Subjekti do të marrë në dorëzim të gjithë fondin bimor të drurëve, shkurreve etj, dhe do të garantojë ruajtjen e tyre.

Për çdo dëmtim jo për arsye shërbimi, subjekti duhet të mbajë process-verbalet përkatëse konform ligjit dhe akteve të K.B.Kurbin dhe do të informojë menjëherë bashkinë (Sektorin e Shërbimeve Publike)

Për të gjitha dëmtimet për shkak të moskryerjes së shërbimeve, subjekti do të ngarkohet me përgjegjësi materiale nga Bashkia (supervizori) dhe do të bëjë zëvendësimet eventuale me shpenzimet përkatëse në kohën e përcaktuar.

Aktiviteti i ruajtjes, shtimit dhe mirëmbajtjes së gjelbërimit është i përcaktuar dhe jepet sipas inventarit që i bashkangjitet projektit dhe hartave në planimetri (Plan vendosje)

Për çdo mungesë që mund të rezultojë në inventar, subjekti duhet të kundërshtojë që në fillim të aktivitetit.